



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:089775
Datë: 31.07.2023
Numri i dokumentit: 04540564

C.nr.1240/23

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtaren Njomëza Berisha, në çështjen juridiko- kontestimore të paditësit D.R., me numër personal, me vendbanim në Prishtinë, rruga “.....” Kompleksi, të cilin me autorizim e përfaqëson av. M.G., nga Lipjani, rruga “.....”, nr....., kundër të paditurit, Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", me seli në Prizren, me objekt të kontestit anulimin e vendimit, me datë 31.07.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET SE ËSHTË TËRHEQUR padia me numër C.nr.1240/23, e paditësit D.R., kundër të paditurit Universiteti i Prizrenit ” Ukshin Hoti” me seli në Prizren, për shkak të anulimit të vendimit.

A r s y e t i m

Paditësi D.R., nga Prishtina, përms të autorizuarës së tij av.M.G.; nga Lipjani me datë 14.04.2023, pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi kundër të paditurit Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”, me seli në Prizren, për shkak të anulimit të vendimit.

Me parashtresën e datës 26.07.2023, e autorizuar e paditësit, av.M.G., nga Lipjani, e kishte tërhequr padinë e ushtruar pranë kësaj gjykate kundër të paditurit Universiteti i Prizreni”Ukshin Hoti”.

Neni 261 par.1 i LPK-së parasheh: “ *Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi.*” Par.3 i po këtij neni parasheh: “*Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë*”.

Në këtë drejtim, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore për të konstatuar të tërhequr padinë e paditësit D.R., kundër të paditurit Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”, e duke bazuar në nenin 261 pika 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së), pasi që në rastin konkret i padituri Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”, nuk ka paraqitur në gjykatë përgjigje në padinë e paditësit.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2023:089775, 31.07.2023

G j y q t a r j a

Njomëza Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.